



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”
GJIROKASTËR
QENDRA E TË MËSUARIT GJATË GJITHË JETËS

Nr. ____ Prot.

Gjirokastrë, më ____ .06.2024

Lënda: Për pasqyrim në faqen zyrtare Web të UGJ-së të veprimatarisë trajnuese në kuadër të Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025.

REKTORIT

Prof. Dr. Bektash MEMA

Universiteti i Gjirokastrës si Agjensi Trajnuese e Akredituar u bë pjesë e iniciativës Kombëtare për zhvillimin profesional të mësuesve 2024-2025, “*Fuqia transformuese e zhvillimit të vazhdueshëm profesional për mësuesit në fushat: Gjuhë, Matematikë, Shkenca dhe Teknologji (STEM)*”.

Në një sistem arsimor gjithnjë e në zhvillim, roli i mësuesve i kapërcen kufijtë e tradicionales. Mësuesit e sotëm kanë për detyrë jo vetën të japin njohuri, por edhe të kultivojnë mendimin kritik në Gjuhë, Matematikë, Shkencë dhe TIK. Përqaftimi i kësaj sfide kërkon përkushtim ndaj të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke e bërë zhvillimin e vazhduar profesional domosdoshmëri për mësuesit.

➤ **Të lexuarit** si gur themelor i komunikimit nuk duhet të kufizohet në format tradicionale, por duke qënë në një epokë digjitale, të lexuarit përfshin edhe burimet multimediale, duke i udhëhequr nxënësit në të kuptuarit dhe vlerësimin kritik të informacionit.

➤ **STEM** si qasje arsimore ndërdisiplinore integron katër fusha: Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë. Qëllimi është t’u ofrojë nxënësve njohuri dhe aftësi në zgjidhjen e problemeve dhe kreativitetin, zbatimet në botën reale.

- **Matematika:** Mësuesit e pajisur me njohuritë bashkëkohore pedagogjike mund ti transformojnë parimet abstrakte matematikore në zbatime te prekshme të jetës reale.
- **Shkenca** pasuron të kuptuarit për konceptet shkencore dhe ndezin në klasë ndjenjën e kuriozitetit te nxënësit.
- **Teknologjia** nuk është thjesht një detyrim profesional por një kontekst i domosdoshëm bashkimi i të gjitha burimeve dhe aftësive për të përballuar sfidat e kohës.

Trajnimet në kuadër të Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve synojnë:

1. Trajnimin e mësuesve të arsimit fillor për aftësitë që vlerësohen në studimet ndërkombëtare PIRLS, TIMSS, sipas qasjes STEM.
2. Trajnimin e mësuesve të lëndëve / profileve: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë dhe Shkencat e natyrës (Fizikë, Biologji, Kimi) për aftësitë që vlerësohen në studimin ndërkombëtar PISA dhe sipas qasjes STEM.

Nisur nga shpërndarja gjeografike trajnimet për fazën e parë Prill – Maj 2024 u zhvilluan nga Agjensia Trajnuese Universiteti i Gjirokastrës (rajoni 7), si më poshtë:

- **Sarandë**, ku u përfshinë ZVAP- të : Finiq - Dropull dhe Sarandë – Konispol - Delvinë
- **Gjirokastrë**, ku u përfshinë ZVAP-të : Gjirokastrë - Libohovë, Përmet - Këlcyrë dhe Tepelenë - Memaliaj.

Universiteti i Gjirokastrës përfundoi me sukses fazën e parë të trajnimeve Prill-Maj 2024 duke siguruar kapacitetet infrastrukturore të nevojshme në mbarëvajtjen e zhvillimit të moduleve. Në këtë fazë të parë u zhvilluan trajnime me **34** grupe dhe u trajnuan **646** mësues për modulën e parë të trajnimit ku u përfshinë mësues të arsimit fillor, mësues AMU dhe AML të kimisë, biologjisë, fizikës, matematikës dhe drejtuesit e shkollave, oficerët e sigurisë dhe punonjësit e shërbimit psiko –social.

KOORDINATOR

Msc. Marjeta FULE



































